VENDIM
Nr. 448, datë 19.6.2026

PËR MIRATIMIN E NDËRTIMIT TË CENTRALIT GJENERUES TË ENERGJISË ELEKTRIKE FOTOVOLTAIKE DHE VEPRAVE NDIHMËSE, I CILI NUK ËSHTË OBJEKT KONCESIONI, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË DEVOLL, QARKU KORÇË, NGA SHOQËRIA "DEVOLLI *SUNPOWER*" SHPK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni dhe nuk përfiton nga masat mbështetëse, me vendndodhje në Bashkinë Devoll, qarku Korçë, nga shoqëria "Devolli *Sunpower*" sh.p.k., me elementet, si më poshtë vijon:

a) emri i aplikuesit: shoqëria "Devolli *Sunpower*" sh.p.k.;

b) numri i identifikimit personal të zyrës së taksave NIPT/NUIS: M26915601L;

c) tipi i centralit: fotovoltaik;

ç) kapaciteti i instaluar: 15 mw;

d) afati i pritshëm i vënies në punë dhe pajisja me leje ndërtimi: koha për ndërtimin, pajisjen me lejen e ndërtimit dhe vënien në operim të impiantit fotovoltaik do të jetë brenda 36 (tridhjetë e gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;

dh) vendndodhja e burimit gjenerues të energjisë: në Bashkinë Devoll, qarku Korçë;

e) afati i operimit: 49 (dyzet e nëntë) vjet nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;

ë) koordinatat e tokës, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

f) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore kanë të drejtë të ushtrojnë mbikëqyrje të përgjithshme me afate 3-mujore gjatë realizimit, vënies në punë dhe operimit, me synim që të verifikojnë se ecuria e punimeve, cilësia, konformiteti dhe operimi janë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe të dokumentacionit të projektit;

g) shoqëria "Devolli *Sunpower*" sh.p.k. ka detyrimin, që:

i. të paraqesë periodikisht (çdo tre muaj) pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore informacion për ecurinë e ndërtimit të centralit fotovoltaik;

ii. të respektojë kushtet e cituara në lejet, licencat dhe autorizimet paraprake mjedisore, lëshuar nga institucionet përgjegjëse kombëtare;

iii. të dorëzojë sigurimin e kontratës, në masën jo më pak se 5% të vlerës së investimit, përpara nënshkrimit të kontratës ndërmjet shoqërisë "Devolli *Sunpower*" sh.p.k. dhe ministrisë. Në këtë kontratë përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve për realizimin e këtij projekti, penalitetet, në rast mosrealizimi, si dhe çështje të tjera që lidhen me zbatimin e saj;

iv. t'i japë falas, në formë *royalty*, ministrisë përgjegjëse për energjinë sasinë e energjisë elektrike, në masën 2 (dy) % të sasisë vjetore të prodhimit të energjisë elektrike ose konvertimin e saj në vlerë monetare. Në rast konvertimi në vlerë monetare, shuma duhet të derdhet tërësisht në buxhetin e shtetit;

v. të përmbushë kërkesën, sipas rastit, që një pjesë e prodhimit të burimit gjenerues të energjisë t'i shitet furnizuesit publik, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shoqëria "Devolli *Sunpower*" sh.p.k. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

ANEKS 1

CENTRALI GJENERUES I ENERGJISË ELEKTRIKE FOTOVOLTAIKE DHE VEPRAVE NDIHMËSE, I CILI NUK ËSHTË OBJEKT KONCESIONI, NË BASHKINË DEVOLL, QARKU KORÇË, NGA SHOQËRIA "DEVOLLI *SUNPOWER*" SHPK

Koordinatat ne sistemin KRGJSH		
	x	y
1	585693	4497624
2	585846	4497619
3	585865	4497636
4	586057	4497649
5	586112	4497712
6	586021	4497854
7	586039	4497881
8	586021	4497996
9	586059	4498150
10	586039	4498193
11	586027	4498200
12	585997	4498304
13	585936	4498332
14	585868	4498226
15	585794	4497891

Koordinatat ne sistemin GK		
	x	y
1	4501193	4497261
2	4501346	4497255
3	4501365	4497272
4	4501557	4497283
5	4501613	4497345
6	4501524	4497488
7	4501542	4497514
8	4501526	4497629
9	4501565	4497784
10	4501545	4497827
11	4501534	4497834
12	4501504	4497938
13	4501444	4497967
14	4501375	4497861
15	4501297	4497528